



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Nr. 2014 Prot.

Vlorë, më 29/09 / 2025

VENDIM

Nr. 20 Datë 25/09 / 2025

**“PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË
ADMINISTRIMIT TË SHOQËRISË “BAJKAJ LAND” Sh.A.”.**

Këshilli i Qarkut Vlorë, në cilësinë e Asamblesë së ortakëve, në mbledhjen e datës 25/09 / 2025, bazuar në Ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, neni 9, pika 1.1/b dhe d dhe neni 77, pika 7, në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, neni 135, pika 2/c dhe 4, në Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", VKQ nr. 39 datë 11/11/2014, VKQ nr. 8 datë 05/04/2019 "Për miratimin e një ndryshimi në Këshillin e administrimit të shoqërisë Bajkaj Land Sh.a.", Statutit të Shoqërisë "Bajkaj Land" Sh.a; VKQ nr. 20 datë 29/12/2023 "Për një ndryshim në Këshillin e administrimit të shoqërisë Bajkaj Land Sh.a.", si dhe nenet 13, 18, 19 dhe 20 të Statutit të Shoqërisë "Bajkaj Land" Sh.a.

VENDOSI:

1. Të konfirmojë z. Harallamb Pandehi dhe z. Altier Xhaferri si anëtarë të Këshillit të Administrimit të shoqërisë "Bajkaj Land" Sh.a.
2. Të bëhet ndryshimi në përbërjen e Këshillit të Administrimit të shoqërisë "Bajkaj Land" Sh.a, ku znj. Ina Zhupa të zëvendësohet me znj. Eliana Shkurti.
3. Për ndjekjen e procedurave ligjore në zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut ose personi i autorizuar prej tij dhe Administratori i shoqërisë "Bajkaj Land" Sh.a.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas parashikimit të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore, i ndryshuar.

KRYETAR

Ervis Moçka

Shpallur nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresë Nr. 913 / Prot., datë 02 / 10 / 2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE



RELACION

“PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË ADMINISTRIMIT TË SHOQËRISË “BAJKAJ LAND” Sh.a.”.

Të Nderuar anëtarë!

Shoqëria “Bajkaj Land” Sh.a. është krijuar me vendimin Nr. 39 datë 11.11.2014 të Këshillit të Qarkut Vlorë dhe në muajin shtator 2015, ka filluara aktivitetin e saj ekonomik, për vënien në punë të landfillit në shërbim të 5 Bashkive të Qarkut Vlorë (Sarandë, Delvinë, Finiq, Konispol dhe Himarë) si dhe eneteve të tjera publike dhe private.

Shoqëria "BajkajLand" Sh.a menaxhon landfillin e ndërtuar në fshatin Bajkaj në Bashkinë Delvinë në kuadër të projektit "Menaxhimi i Integruar dhe Pastrimi i Zonës Bregdetare".

Bazuar në statutin e shoqërisë me qëllim mbikqyrjen dhe drejtimin e aktivitetit të shoqërisë Këshilli i Qarkut Vlorë në cilësinë e Asamblesë së ortakëve (si ortak i vetëm), cakton përfaqësuesit në Këshillin e Administrimit të shoqërisë Bajkaj Land Sh.a, i cili përbëhet nga 3 anëtarë. Prej qershorit 2 prej anëtarëve u ka mbaruar mandati 3 vjeçar dhe për këtë arsye lind nevoja e vendimarrjes nga ana e Këshillit.

Duke u nisur dhe nga konsultimet me Bashkitë përfituese dhe propozimet e tyre, propozohet rikonfirmimi i anëtarëve Harallamb Pandehi dhe Altier Xhaferri, të cilëve u ka përfunduar mandati. Ndërkohë që me propozim të Bashkisë Sarandë kërkohet ndryshimi i anëtarit Znj. Ina Zhupa të cilës mandati i mbaron në vitin 2026 me Znj. Eliana Shkurti.

Bazuar në Ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 9, pika 1.1/b dhe d dhe neni 77, pika 7, në Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, neni 135, pika 2/c dhe 4, në Ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, VKQ nr. 39 dt. 11/11/2014, VKQ nr. 8 dt. 05/04/2019 “Për miratimin e një ndryshimi në Këshillin e administrimit të shoqërisë Bajkaj Land Sh.a”, Statutit të Shoqërisë “Bajkaj Land” sh.a; VKQ nr. 20 dt. 29/12/2023 “Për një ndryshim në Këshillin e administrimit të shoqërisë Bajkaj Land Sh.a”, nenet 13, 18, 19 dhe 20 të Statutit të Shoqërisë “Bajkaj Land” sh.a, sillet për miratim P/Vendimi i cili konfirmon për një mandat të ri 3 vjeçar anëtarët Harallamb Pandehi dhe Altier Xhaferri dhe ndryshimin e Znj. Ina Zhupa me Znj. Eliana Shkurti. Ju ftojme që të procedojmë me miratimin e këtij projektvendimi.



KRYETAR

Ervis Moeke